



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 400-01/76387, datë: 29 Tetor 2024.

Në bazë të nenit 12. pika 2 (d), të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 20 paragrafi 1, pika 1.4. dhe nenit 84 të Statutit të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, e nenit 39 paragrafi 1 i Rregullorës Nr.02/2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, I. Numer: 01-060/017031 dt.09. 03.2021, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Tetor 2024, pas miratimit në parim dhe procedurave të diskutimit publik të Draft Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026, merr këtë:

VENDIM

Nr.60/2024

Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026

1. MIRATOHET Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
3. Për Zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim sëbashku me Zyrën Kryetarit të Komunës së Pejës.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 (shtate) dite pas publikimit në Ueb Faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL,
Kryetarit të Komunës,
Drejtorisë për Arsim,
Arkivë.

